



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE

18 shtator 2012, Prizren

REAGIM

Institucionet të vepronë karshi shkelësve të ligjit

EC Ma Ndryshe tash e disa javë ka përcjellë angazhimet e Inspektorëve të komunës dhe të DUPH-së në lidhje me ndërtimet pa leje dhe tejkalimet në objektet e banimit kolektiv në Prizren. Vendosija e shiritave për ndërprerjen e punimeve në vend punishte të ndryshme brenda zonës urbane të Prizrenit më 12 shtator 2012 dhe më parë në fund të muajit gusht edhe pse ka qenë një masë e vonuar, megjithatë ka qenë hap i duhur në drejtim të vënies së ligjshmërisë në sektorin e urbanizimit.

Mirëpo, mos respektimi i kësaj mase dhe largimi i shiritave të inspektorëve, sikurse edhe vazhdimi i punimeve nga ana e investitorëve në objektet në ndërtim e sipër në lagjet “Jeni Mëhallë”, te “Parku i Qytetit” e në “Terzi Mëhallë” përkundër urdhrin zyrtar paraqet shkelje ligjore dhe një shqetësim që lidhet drejtpërdrejtë me funksionimin e institucioneve shtetërore.

EC Ma Ndryshe përmes këtij reagimi i bën thirrje të gjitha institucioneve të pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe atij gjyqësor të Prizrenit që të ndërmarrin veprime të duhura në kuadër të kompetencave që kanë dhe të sigurojnë zbatimin e ligjit në sektorin e urbanizimit.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Transparenca online e komunës së Prizrenit” prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.